



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1265 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_ .2023

**“PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9/1 , pika 1.1/b pika 2, 9, neni 54 pika II, neni 55 pika 2 , në shkresën datë 05.09.2020 të Z.Arben Meksi dhe Z.Pirro Stefa si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë emërtimin e rrugës pranë Bulevardit “Ismail Qemali” me emrin “Erid Hamzaraj” sipas planvendosjes bashkelidhur .
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”.

Shanc: J. Hoxh'k'cep



**KRYETARI**

**Dritan Leli**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 1265 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

**RELACION**

**MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË”**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Ky projektvendim është hartuar bazuar në kërkesën e datës 05.09.2020 Z.Pirro Stefa dhe Z. Arben Meksi dhe gjen bazë në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, 9, neni 54 pika II, neni 55 pika 2 .

Nga kërkesit është propozuar që Këshilli i Bashkisë Vlorë të emërtojë rrugën pranë Bulevardit “Ismail Qemali” me emrin “Erid Hamzaraj” sipas planvendosjes bashkelidhur kërkesës.

Kërkesit e bazojnë këtë kërkesë në propozimin e Zyrës së Urbanistikës Bashkia Vlorë , për periudhën e aktivitetit të tij si drejtues i Byrosë së Studim Projektimit dhe në Zyrën e Urbanistikës prej vitit 1991 deri në 1997.

Erid Hamzaraj ka lindur me 1 tetor 1964 në Vlorë dhe është diplomuar si inxhinier në vitin 1991 në Universitetin Politeknik të Tiranës .

Në vitin 1994 , i përzgjedhur nga vetë Ambasadori i Italisë , specializohet në Politeknikun e Milanos dhe dekorohet me medalje nderi.

Realizoi në Milano rikonstruksionin dhe zhvillimin e godinës shtetërore të “ANAS-Agjencisë Italiane të Rrugëve”.

Më pas kthehet në Shqipëri dhe fillon punë në Zyrën e Urbanistikës pranë Bashkisë Vlorë.

Erid Hamzaraj ishte njeriu që hodhi gurin e parë në zhvillimin urban të qytetit të Vlorës dhe në mentalitetin e ri demokratik që Bashkia , shoqëria dhe qyteti përqafoi pas viteve 90.

Erid Hamzaraj ishte personalitet i spikatur i një brezi të ri ndërtuesish , inxhinierësh , arkitektesh dhe planifikuesish urban të cilët me punën e tyre dhe përpjekjet e mundimshme i dhanë jo vetëm fizonomi urbane por sidomos identitetin qytetit të Vlorës.

Qyteti i Vlorës ka bërë një rrugë të gjatë drejt modernizimit urbanistik dhe Erid Hamzaraj ka qënë një pioner dhe përfaqësues i denjë që në gjenezë të këtij modernizimi.

Emri i tij përfaqëson kujtesën e një epoke të vështirë për qytetin tonë dhe qëndron në plejadën e personaliteteve më të nderuara të saj .

Në vitet e vështira 91-97 Erid Hamzaraj dha një kontribut të cmuar në fushën e projektimit dhe zhvillimit , si një figurë e pastër me vlera të mëdha humane , sociale dhe profesionale , si një njeri i zgjuar , i urtë dhe fjalëpak , një vlerë e shtuar për Bashkinë Vlorë dhe për qytetin e Vlorës .

### **Të nderuar Këshilltarë !**

Nga sa më lart është në vlerësimin tuaj të miratoni emërtimin e kësaj rruge “ Erid Hamzaraj” si nderim dhe lartësim i modeleve më të mira qytetare dhe profesionale por dhe per një përfaqësim dinjitoz të një brezi të tërë njerëzish që hodhën themelet e transformimit urbanistik në një epokë të re për qytetin tonë.

Konceptoi:S.Haxhiraj

**KRYETARI**

**Dritan Leli**



Vlorë, më 05. 09 .2020

## KËRKESË

### Kërkues:

Ark. Arben Meksi

Ark. Pirro Stefa

### Drejtuar: Bashkise Vlorë, Këshilit Bashkiak Vlorë

Paraqesim sot para institucionit tuaj kërkesën tonë, në statusin e arkitekteve dhe personaliteteve të spikatura në fushën e projektimit arkitekturor në qytetin e Vlorës, me një aktivitet të mirënjohur shumëvjeçar.

Kerkesa jonë konsiston në marrjen në konsideratë nga ana juaj, te mbeshtetjes dhe referencës sonë lidhur me propozimin e Zyrës së Urbanistikës pranë Bashkisë Vlorë për vlerësimin e figures së të ndjerit Ing. Erid Hamzaraj, në formën e emërimit të një rruge me emrin e tij.

Perkrahim fuqimisht propozimin e Zyrës së Urbanistikës, si kolegë dhe bashkëpunëtorë të të ndjerit Hamzaraj në periudhen e aktivitetit të tij si drejtues i Byrose se Studim Projektimit dhe më pas Zyrës së Urbanistikës prej vitit 1991 e deri më 1997.


Në këto vite të turbullta dhe të vështira, shërbejmë si dëshmitarë të kontributit të tij të cmuar në fushën e projektimit dhe zhvillimit, si një nga pionerët e urbanistikës në periudhën e demokracisë në qytetin e Vlorës. Japim garanci të plotë për pastertinë e figurës se tij, vlerave të mëdha humane e sociale dhe vlerave te padiskutueshme profesionale.

Emërtimi i një rruge me emrin e tij, do të shërbejë jo vetëm për nderimin dhe lartësimin e modeleve më të mira qytetare dhe profesionale, por edhe për perfaqësimin dinjitoz të një brezi të tërë njerëzish që hodhën themelet e transformimit urbanistik në një epokë të re për qytetin tonë.

Qyteti ynë ka bërë një rrugë të gjatë drejt modernizimit urbanistik. Është momenti i duhur që të vlerësojmë gjenezat dhe pionerët e nderuar, që në gjykimin tonë dhe të kolegëve tanë, përfaqësohen denjësisht nga i ndjeri Ing. Erid Hamzaraj.

Emri i tij përfaqëson gjithashtu kujtesën e një epoke pak të prekur në ditët e sotme dhe qëndron në plejaden e personaliteteve më të nderuara të saj. Vlora 91-97 lidhet ngushtë me emrin Erid Hamzaraj.

Bashkangjitur me kërkesën paraqesim referencën tonë për figuren e Ing. Erid Hamzaraj.

ark. Pirro Stefa  


ark. Arben Meksi  




## **Erid Hamzaraj - Historik i shkurter i jetes**

Erid Agim Hamzaraj ka lindur me 1 Tetor te vitit 1964 ne Vlore ne familjen Hamzaraj, nje nga familjet e vjetra fisnike te qytetit. I ati, Agimi, ka punuar pergjegjes llogarie, kurse e ema, Nedjatte Llupa, e ardhur po nga nje familje e dalluar qe ka nxjerre personalitete te shquara te qytetit, ka qene mesuese matematike e spikatur dhe e dekoruar me urdherin "Naim Frasheri i Arte", duke edukuar breza te shumte ne periudhen e regjimit komunist.

Hamzaraj ka kryer shkollimin parauniversitar ne shkollen Halim Xhelo duke spikatur me rezultate te shkelqyera dhe prirje premtuese ne shkencat ekzakte. Pas perfundimit te shkolles se mesme, fale rezultateve te tij, do te fitoje pas 3 vitesh te drejten e studimit ne Universitetin Politeknik te Tiranes ne degen e Inxhinierise se ndertimit. Ne kete fakultet ka studiuar prej vitit 1986 dhe ka marre titullin inxhinier ne vitin 1991 me noten mesatare 9.8, nje rezultat i shkelqyer ky ne nje fakultet elitar.

Pas perfundimit te fakultetit, deshira per te kontribuar per qytetin e Vlores e ben te marre vendimin per tu kthyer ne qytetin e lindjes, duke u emeruar ne vitin 1991 si drejtor i Byrose se Studim-Projektimit Vlore.

Ne vite te veshtira te rikonceptimit urbanistik pas komunizmit, qendron ne balle te reformimit te sistemit, per orientimin e ndertimit ne funksion te nismes se lire dhe iniciatives private.

Ne vitin 1994, i perzgjedhur nga vete ambasadori, fiton nga ambasada italiane te drejten e specializimit ne prestigjozin Politekniku i Milanos, nga i cili del me rezultate te shkelqyera duke u dekoruar me medaljen e nderit te universitetit teknik me te mire ne Itali dhe nder me te rankuarit ne bote. Realizon ne Milano rikonstruksionin dhe zhvillimin e godines shteterore te "ANAS - Agjencise Italiane te Rrugeve". Pavaresisht ofertes se punes nga po kjo agjenci, per ndertimin e autostrades Bologna-Milano, kthehet ne Shqiperi serish per te ndermarre projekte te tjera ne postin e drejtorit te Zyres se Urbanistikes ne bashkine e Vlores.

Me nje kulture dhe eksperience perendimore, fillon punen per te sjelle ne Vlore nje fryme zhvillimi europiane.

*Me konsulencen edhe te firmave italiane te urbanistikes, realizon pas ardhjes se demokracise, studimet e para te plota per zhvillimin e qytetit post komunizem.*

*Nen kujdesin e tij, fillon per here te pare aplikimi i modeleve perendimore ne projektimin dhe zbatimin e ndertimit te godinave shumekateshe te projektuara mirefill me funksione banimi dhe sherbimi njekohesisht.*

*Gjithashtu, realizohet shtrirja urbane e Vlores ne drejtim te jugut, duke shnderruar zonen e Skeles nga nje zone periferike, ne nje zone me kapacitet te madh banimi, ne zgjatim te bulevardit ekzistues Ismail Qemali.*

*Pavaresisht veshtiresive te jashtezakonshme, ruan pozitat e tij ne krye te Urbanistikes duke bashkepunuar per nje kohe te shkurter me 3 kryetare bashkie, arkitekte e inxhinier e duke siguruar vazhdimesine e fizionomise se tij.*

*Ne Shkurt te vitit famekeq 1997, njerez keqedashes djegin godinen e bashkise Vlore.*

*Hamzaraj perdor nje hyrje te pasme per t'u futur ne godine mes flakeve dhe tymit, duke arritur te nxjerre dhe te shpetoje arshiven dhe dokumentacionin e Zyres se Urbanistikes. E strehon dokumentacionin ne shtepine e tij deri ne normalizimin e situates kaotike. Pas perfundimit te trazirave, familja i kthen bashkise arshiven e shpetuar nga flaket.*

Fatkeqesisht, ne 6 Mars, ne trazirat e vitit 1997, ne moshen 33 vjecare, nderron jete ne menyre te pa zbardhur, bashke me te emen duke udhetuar per ne Vlore. Ne kete vit te mbrapshte, Vlora humbet nje nga djemte me brilante te saj, duke nderprere njehere e pergjithmone punen e tij per nje Vlore europiane.

Pavaresisht se puna e tij u nderpre ende ne fillim te saj, Erid Hamzaraj ishte nga ata njerez qe hodhen gurin e pare jo vetem ne zhvillimin urban te qytetit, por edhe ne mentalitetin e ri demokratik qe bashkia, shoqeria dhe qyteti perqafoi pas viteve '90.

Erid Hamzaraj eshte i njohur nga vlonjatet si njeriu i zgjuar, i urte dhe fjalepak, i cili u gjendej prane qytetareve pa dallim, duke u shnderruar ne nje model dhe shembull te vlerave me te mira qytetare vlonjate. Referenca me e mire per shembullin qe ai perfaqesonte, jepet vete nga njerezit e shumte qe e njohen dhe paten te benin me te ne sferen njerezore dhe profesionale.

Fale kapacitetit te tij te larte njerezor, profesional, intelektual, ai ishte nje vlere e shtuar e institucionit te bashkise por edhe e te gjithe qytetit.

Duke emertuar nje rruge pas tij, Vlores i kthehet djali i saj i humbur, pikerisht ne nje nga zonat kryesore te cilat ai vete studioi dhe zhvilloi ne epoken post-komunizem.

## REFERENCË

”  
PER RIDIN, SI MIK, SI KOLEG...

ERID HAMZARAJ po te jetonte sot do te ishte 56 vjec , do te ishte padiskutim nje nga perfaqsesit e denje te nje gjenerate te re, qe ndryshuan kete qytet menjehere pas viteve 90 , duke trashëguar cilesite me te mira te tradites qe ndertoi Vloren e Re qe gezojme sot. Ata qe kane ndertuar kete qytet nuk jane as nje e as disa, por disa dhjera apo qindra ndertues anonime te cilet kane perfaqsesit e tyre, sic eshte ne kete rast ERID HAMZARAJ nje personalitet i spikatur i nje brezi te ri ndertuesish, inxhinieresh, arkitektesh e planifikuesish urbane te cilet me punen e tyre dhe perpjekjet e mundimshme i dhane jo vetem fizionomine urbane por sidomos identitetin ketij qyteti pa te cilin ne te gjithë nuk bejme dot .

ERID HAMZARAJ iku prej nesh ne moshen 33 vjecare, ne nje nga momentet e jetes me fuqi te pakrahueshme transformuese, duke patur nje trajektore mjaft te shpejte larg asaj klasike, pothuaj te pabesueshme. Ai ishte njeri i lartësive, filloi lart dhe iku po ashtu lart, duke mbetur nje figure unike e ndertimit, projektimit, planifikimit urban, vizionit per qytetin, qe ai e desh fort dhe kontribuoi deri ne fund edhe pse midis veshtiresive te medha te atyre viteve.

ERID HAMZARAJ u nda tragjikisht nga jeta ne nje moshe mjaft te re por i realizuar, me nje karriere te plote, me talent te lindur dhe personalitet profesional e njerezor te padiskutueshem, si mik, si koleg, si inxhinier, si drejtues, si intelektual e si familjar...

Por keshtu e desh jeta dhe fati i tij, te flijohej ne menyre te panevojshme e madje absurde ne nje moment kur me shume se cdo gje ai kishte fuqi krijuese, transformuese, vizionin per qytetin qe po shkonte mes veshtiresish te pakuptimta drejt se ardhmes.

Duke i vene nje rruge te qytetit emrin e ERID HAMZARAJ, ne te gjithë i bejme atij nje lutje njerezore te kthehet serish midis nesh, duke bere nje perkujdesje te vonuar per ta patur prane nesh autoritetin e tij profesional e njerezor, talentin dhe kontributin, duke na kujtuar se te gjithë jemi te perkohshem, vijme e ikim, por ndonjeri duhet te vazhdoje te jete ketu per te treguar rrugen, vizonin e te ardhmen e qytetit; duhet te vazhdoje te jete ketu per te treguar Vloren e djeshme, te sotme por sidomos te nesërme, e cila bashkon endrrat e te gjithëve, te atyre qe jane e te atyre qe s'jane, sepse Vlora mbetet, ajo eshte "shtepia jone e madhe".

Duke i vene nje rruge te qytetit emrin ERID HAMZARAJ, ai eshte i mirepritur, eshte midis nesh....

Ark. PIRRO STEFA

”  


”  
Per te njohur figuren e nje njeriu duhet pare origjina e tij, prejardhja familjare e cila percakton themelet e cdo personaliteti njerezor. Erid Hamzaraj rrjedh nga nje familje e degjuar vlonjate, me tipare qytetare, patriotike, atdhetare dhe dituri-dashese.

Prinderit e tij te nderuar, trashегuan tek dy femijet e tyre vlerat me te mira njerezore, vullnetin per dije dhe dashurine per njerezit. Vete Ridi ndertoй nje familje model edhe pse me nje bashkejetese te shkurter, te cilen fati e nderpreu pabesisht.

Ai punoi ne nje kohe shume te veshtire per qytetin, ku tranzicioni duhej bere ne te gjitha planet shoqerore dhe ekonomike pergjate periudhes 1990-1997.

Akoma me i veshtire u be ky tranzicion ne fushen e projektimit dhe ndertimit.

Si inxhinier, por edhe si pergjegjes i byrose se projektimit dhe urbanistikes, ai shkelqeu jo vetem per organizimin dhe modernizimin e saj, por edhe per vizionin e tij, per nje qytet ndryshe, i cili duhej te pershtatej me konceptet e reja te marredhenieve me pronen private.

Kjo gje u reflektua ne studimet bashkekohore urbanistike qe kjo zyre beri qysh ne vitet e para te drejtimit te tij. Ai hodhi themelet e nje organizimi te ri te zyres duhe u mbeshtetur mbi teorite moderne te projektimit ku dobia, fortesia dhe bukuria ishin primare.

Gjurmet e punes se tij, menyra e komunikimit, bota e tij e madhe shpirtore, marredheniet e mira me arkitekthe dhe inxhiniere te degjuar te qytetit, kane lene kujtime te pashlyera tek gjithekush qe e ka njohur, duke fituar respekt te vecante. Te gjithе tek Ridi shikonin inxhinierin me shume te ardhme ne profesion dhe ne karriere.

Ridi ishte student model dhe me rezultate maksimale gjate kohes qe studionte. Edhe ne Milano doli student i pare me rezultatet me te larta te sistemit italian.

Pas perfundimit te studimeve ne Itali, atij iu ofruan oferta pune per te qendruar, por ai kishte vendosur qe gjithcka qe dinte dhe mesonte ta vendoste ne sherbim qe qytetit te tij te lindjes.

Ne nje bisede me nje pedagog ne Milano e pati te veshtire ti thoshte qe Vlora ishte qytet pa semafore. Per here te pare ai u be iniciator per vendosjen e semaforeve ne disa kryqezime, te cilat funksionuan per disa vite. Ridi ishte konstruktori i pare ne Vlore qe kaloi nga llogaritjet manuale per konstruksionet ne llogaritjet kompjuterike.

Projektet qe beri, i realizoi me keto metoda: si projekti per mbulesen e stadiumit Flamurtari si dhe zgjerimin e tij nga te gjitha anet, projekte konstruktive per shkolla private, projekte konstruktive per banesa private, hotele, apo objekte te tjera shoqerore, te cilat ai i llogariti me keto metoda bashkekohore.

Te punoje me Ridin ishte privilegj. Brenda natyres se tij te ndrojtur zbulojte nje njeri me bote te madhe me sy plot jete dhe shkelqim, njeri inteligjent dhe i gatshem per ndihme.

Per jeten e tij te shkurter, per punen e tij te madhe, ai meriton vleresimet maksimale, si nje mirenjohje per gjithcka la trashегim, si nje model i mire per te gjithе, duke na lene si kujtim shprehjen: „Nuk eshte sasia e viteve qe jeton e cila percakton jeten e nje njeriu, por cilesia e vlerave qe ai le trashегim“.

Ark. ARBEN MEKSI

”  






REPUBLIKA ESHQIPËRISË  
BASHKIA V Lorë  
DREJTORIA E URBANISTIKËS

Nr. 1265 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

Relacion

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë, Vlorë

Lenda : Relacion në lidhje me emërtimin e rrugës “ Erid Hamzaraj”.

Baza ligjore: Ligji nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 9/1 dhe 1/b, neni 54 pika II, neni 55 pika 2.

Të nderuar Këshilltarë,

Sic rezulton nga dokumentacioni që jeni duke shqyrtuar, dhe që Drejtorisë së Urbanikës i është vënë në dispozicion, nga ana e jonë është kërkuar përcaktimi i vendodhjes dhe përpilimi i planimetrisë së rrugës që do të emërtohet me emrin Erid Hamzaraj.

Së pari nga ana e zyrës sonë është shprehur miratimi që një segment i rrugeve të qytetit të mbajë emrin e Erid Hamzaraj.

Ky emër është përzgjedhur, mbi bazën e propozimit sipas shkresën datë 05.09.2020 të Ark. Arben Meksi dhe Ark. Pirro Stefa. Zyra jonë është dakortësuar me këtë propozim , duke e konsideruar sipas vlerësimit dhe argumentave justifikues të propozimit në lidhje me kontributin e Ing.Erid Hamzaraj.

Nga ana e jonë është përzgjedhur ruuges pranë Bulevardit Ismail Qemali sipas planvendosjes të miratuar nga ne.

Nga verifikimet në terren, kjo rrugë rezulton të jetë segment i paemërtuar, dhe nuk ka pengesë për emërtimin e saj.

Bashkalidhur këtij relacioni, planvendosja që përcakton vendodhjen e rrugës.

Konceptoi: *Darjan Hudhra*

Drejtoria e Urbanistikës

Zambak Selmani